



# ÇFARË NDODH PAS DIPLOMIT NGA SHKOLLA

Rezultatet nga  
gjurmimi i të  
diplomuarve  
2017-2022



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për  
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Një partneritet me:



Zbatuar nga:



## **Shkolla e mesme profesionale “Hamdi Bushati” Rezultatet nga gjurmimi i të diplomuarve 2017-2022**

Tetor 2023

### **Rreth projektit “Aftësi për Punë” S4J**

“Aftësi për Punë” S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Sëisscontact. S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

## Tabela e përmbajtjes

<b>1. Hyrje – Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?</b> .....	<b>5</b>
<b>2. Të diplomuarit 2017-2022</b> .....	<b>6</b>
<b>3. Rezultate</b> .....	<b>7</b>
3.1 Statusi i punësimit.....	7
3.2 Lidhja e punës me fushën e arsimit .....	9
3.3 Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës .....	10
3.4 Niveli i pagave.....	11
3.5 Kushtet e punës .....	12
3.6 Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqshmërinë me vendin e punës.....	13
3.7 Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë.....	14
3.8 Mënyrat e gjetjes së punës së parë .....	15
3.9 Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme .....	16
3.10 Të diplomuarit pa punë.....	17
3.11 Propozimet për përmirësim në shkollë .....	20
3.12 Planet për të ardhmen .....	21
<b>4. Përfundime</b> .....	<b>23</b>

## Tabela e figurave

Figura 1 Shpërndarja e gjurmimit sipas drejtimit .....	6
Figura 2 Shpërndarja e gjurmimit sipas gjinisë .....	6
Figura 3 Vendi i banimit (të diplomuarit 2020, 2021,2022).....	7
Figura 4 Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2022).....	8
Figura 5 Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit .....	8
Figura 6 Punësimi përkundrejt vetë-punësimit .....	8
Figura 8 Statusi i punësimit sipas gjinisë (të diplomuarit 2022) .....	9
Figura 7 Statusi i punësimit sipas drejtimit (të diplomuarit 2022) .....	9
Figura 9 Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net).....	11
Figura 10 Punësimi me kohë të plotë përkundrejtë me kohë të pjesshme.....	12
Figura 11 Madhësia e kompanisë .....	12
Figura 12 Lloji i kontratës .....	13
Figura 13 Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi.....	13
Figura 14 Periudha kohore në kërkim të një pune (të diplomuarit 2022) .....	15
Figura 15 Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme .....	16
Figura 16 Llojet e kualifikimeve të mëtejshme .....	17
Figura 18 Lidhja e fushës së studimeve/trajnimeve me profesionin .....	17
Figura 17 Lloji i universitetit.....	17
Figura 19 Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë .....	18
Figura 20 Metodatat e kërkimit për punë (të diplomuar në 2020, 2021, 2022).....	19
Figura 21 Niveli i të diplomuarve papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune .....	19
Figura 22 Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë .....	20
Figura 23 Përzgjedhja e së njëjtës shkollë sipas gjinisë .....	21
Figura 24 Përzgjedhja e së njëjtës degë sipas gjinisë.....	21

## Tabela e tabelave


Tabela 1 Mbulimi i gjurmimit.....	6
Tabela 2 Arsytet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit .....	10
Tabela 3 Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve .....	10
Tabela 4 Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet.....	10
Tabela 5 Perceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale.....	14
Tabela 6 Periudha kohore në kërkim të një pune.....	14
Tabela 7 Mënyrat e gjetjes së punës së parë.....	15
Tabela 8 Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë .....	16
Tabela 9 Arsytet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme.....	17
Tabela 10 Papunësia ndër vite .....	18
Tabela 11 Arsytet kryesore pas punësisë .....	18
Tabela 12 Arsytet kryesore e mos kërkimit për punë .....	19
Tabela 13 Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkallë “shumë/jashtëzakonisht shumë” .....	20
Tabela 14 Përzgjedhja e së njëjtës degë/shkollë sipas drejtimit .....	21
Tabela 15 Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme.....	22

## 1. Hyrje – Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?

**Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës** për të diplomuarit e një institucioni arsimor realizohet përmes ‘studimeve gjurmuese’ që ndjekin ose ‘gjurmojnë’ të diplomuarit pasi ata diplomohen. Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të arsimit profesional në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.

Të dhënat dhe rezultatet e gjurmimit përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi **relevancën e ofertës** për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura. Tematikat e gjurmimit janë të shumfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve.


### Avantazhet e një sistemi gjurmimi në nivel ofruesi



Në këtë kuadër, **shkolla e mesme profesionale ‘Hamdi Bushati’**, me mbështetjen e projektit ‘Aftësi për Punë’ (S4J) ka ngritur një **sistem gjurmimi** në nivel ofruesi për të diplomuarit e saj. Ky sistem gjurmimi përmbush dy qëllime të rëndësishme:

- Monitorimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e shkollës.
- Vlerësimin e lidhjes (përputhshmërisë horizontale) midis arsimit dhe punës.

Zbatimi i procesit të gjurmimit në praktikë zhvillohet në **tre faza kryesore** siç është e ilustruar në diagramën më poshtë.



Në fazën e para-gjurmimit, që kryhet në majin e çdo viti shkollor, realizohet para-gjurmimi i maturantëve që pritet të diplomohen në qershor. Para-gjurmimi kryhet me anë të një pyetësoi të strukturuar online. Anketa mbledh të dhënat e kontaktit të maturantëve, karakteristikat e tyre socio-demografike, si dhe planet dhe pritshmëritë e tyre të karrierës për të mundësuar kështu gjurmimin e tyre një vit më pas.

Në fazën e gjurmimit, që kryhet në qershorin e çdo viti shkollor realizohet gjurmimi i të diplomuarve nga shkolla një vit më parë. Të diplomuarit raportojnë mbi përvojën e kalimit në tregun e punës dhe bëjnë vlerësimin në retrospektivë të shkollës së tyre përmes një pyetësoi të standardizuar online duke përdorur platformën Kobo Toolbox.

Në fazën përmbyllëse të procesit analizohen rezultatet e gjurmimit dhe prezantohen rezultatet. Pjesa më e rëndësishme e procesit është leximi i këtyre gjetjeve dhe reflektimi i brendshëm i institucionit mbi të dhënat dhe ndërmarra e hapave konkrete si rrjedhojë.

Procesi i gjurmimit koordinohet nga **koordinatori i gjurmimit** me mbështetjen e Njësisë së Zhvillimit dhe mësuesve kujdestarë, nën kujdesin e projektit ‘Aftësi për punë’. Ky raport përmbledhës pasqyron rezultatet kryesore nga gjurmimi i **gjashtë brezave me të diplomuar** të shkollës së mesme profesionale ‘Hamdi Bushati’.

## 2. Të diplomuarit 2017-2022

Tabela 1 përmbledh shkallën e pjesëmarrjes në gjurmim sipas brezave të gjurmuar. 100% e të diplomuarve të 2022 u gjurmuan një vit pas diplomimit ose 144/144.

Tabela 1 Mbulimi i gjurmimit

Brezi	Të diplomuar	Të anketuar	%
2016-2017	102	91	89%
2017-2018	87	60	69%
2018-2019	70	56	80%
2019-2020	95	88	93%
2020-2021	93	93	100%
<b>2021-2022</b>	<b>144</b>	<b>144</b>	<b>100%</b>

Figura 1 dhe 2 paraqet shkallën e shpërndarjes në gjurmim sipas drejtimit dhe gjinisë. Në 2022, 75% e të diplomuarve kanë ndjekur drejtimin Hoteleri-Turizëm, 12% drejtimin Ekonomi-Biznes dhe 12% Tekstil-Konfeksion. Prej tyre 70% janë meshkuj dhe 30% vajza.

Figura 1 Shpërndarja e gjurmimit sipas drejtimit






Figura 2 Shpërndarja e gjurmimit sipas gjinisë



Nga të gjurmuarit e diplomuar në 2022, 83% e tyre banonin në Shqipëri dhe 17% (24 nga 144) jashtë Shqipërisë; një indikator i përmirësuar nga një vit më parë, ku 25% e të gjurmuarve kishin emigruar. Të diplomuarit që jetojnë jashtë vendit ndodhen në Angli (4), Gjermani (4), Itali (10), etj.

Figura 3 Vendi i banimit (të diplomuarit 2020, 2021, 2022)



#### Disa nga gjetjet nga paragjurmimi i të diplomuarve në 2021:

- 99% (160 nga 162) e maturantëve u bënë pjesë e paragjurmimit;
- 56% e të paragjurmuarve ishin në marrëdhënie pune - 48% në drejtimin Ekonomi-Biznes, 62% në drejtimin Hoteleri-Turizëm dhe 33% në drejtimin Tekstil-Konfeksion;
- 69% të rasteve puna kishte lidhje me degën e studiuar – 62% Hoteleri-Turizëm, 33% Tekstil-Konfeksion dhe 50% Ekonomi-Biznes.
- Forma se si maturantët kishin gjetur punë: nëpërmjet njohjeve familjare (61%), nëpërmjet mësuesve/njësive të zhvillimit (19%);
- 55% e të paragjurmuarve dëshironin të bëheshin pjesë e tregut të punës pas diplomimit;
- 35% dëshironin të emigronin jashtë Shqipërisë.

### 3. Rezultate

Gjetjet kryesore paraqiten më poshtë të organizuara sipas qëllimeve kryesore të sistemit të gjurmimit.


#### 3.1 Statusi i punësimit

##### Një vit pas diplomimit, cili është statusi i punësimit për të diplomuarit e shkollës?

- Sipas rezultateve të brezit të fundit të të gjurmuarve (2021-2022): 56% janë të punësuar, 8% të vetë-punësuar, 8% janë të punësuar por po studiojnë në të njëjtën kohë, 18% pa punë dhe 8% po ndjekin kualifikime të mëtejshme.
- Të grupuar, 72% e të diplomuarve janë në marrëdhënie pune, duke ruajtur një nivel të lartë punësimi si një vit më parë. Trendi i punësimit ndër vite ka ardhur në rritje.
- Nëse i studiojmë vlerat e punësimit sipas drejtimeve, 73% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, 71% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 67% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksion janë të punësuar një vit pas diplomimit. Krahasuar me një vit më parë përmirësimin më të madh e shohim në drejtimin Tekstil-Konfeksion me 25 pikë përqindje.
- Të dhënat të disagreguara sipas gjinisë tregojnë se djemtë kanë punësueshmëri më të lartë se vajzat, 80% përkundrajtë 59%, ndërkohë që një pjesë e vajzave zgjedhin të vazhdojnë studime të mëtejshme (15%).
- Nga një vlerësim krahasues me brezat e tjerë mund të identifikojmë se në dy vitet e fundit ka një tendencë në zbritje të të gjurmuarve që nuk janë në marrëdhënie pune (30%-32% nga 2017-2020 dhe 23% dhe 18% në 2021 dhe 2022). Paralelisht kemi një trend në zbritje edhe të të diplomuarve që kryejnë studime të mëtejshme (nga 18% tek të diplomuarit në 2017 në 8% në 2022).


- Numri i të diplomuarve të vetë-punësuar në 2022 në terma absolutë është më i larti ndër vite me 12 të vetë-punësuar, ndërsa në terma relative shënon vetëm 8%. Ky numër ka qenë 6 për brezin e të diplomuarve në 2017 (7%), 4 për të diplomuarit e 2018 (7%), 5 në 2019 (9%), 9 në 2020 (10%) dhe 11 në 2021 (12%).

Figura 4 Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2022)




**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: N=144.

Figura 5 Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: N<sub>1</sub>=91, N<sub>2</sub>=60, N<sub>3</sub>=56, N<sub>4</sub>=88, N<sub>5</sub>=93, N<sub>6</sub>=144.

Figura 6 Punësimi përkundrejt vetë-punësimit



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: N<sub>1</sub>=91, N<sub>2</sub>=60, N<sub>3</sub>=56, N<sub>4</sub>=88, N<sub>5</sub>=93, N<sub>6</sub>=144.

Figura 8 Statusi i punësimit sipas drejtimt (të diplomuarit 2022)





Figura 7 Statusi i punësimit sipas gjinisë (të diplomuarit 2022)



**Shënim, figura 7:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N<sub>1</sub>=17, N<sub>2</sub>=109, N<sub>3</sub>=18.

**Shënim, figura 8:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N<sub>1</sub>=90, N<sub>2</sub>=54.

### 3.2 Lidhja e punës me fushën e arsimit

A lidhet puna aktuale e të diplomuarve me fushën e tyre të arsimit?

- Më shumë se gjysma (58%) e të diplomuarve në 2022 pohojnë se puna që ata bëjnë lidhet me studimet e tyre, duke mbajtur një nivel rritës ndër vite.
- 68% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm punojnë në të njëjtën fushë ku kanë kryer studimet, ndërkohë që vetëm 17% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksion pohojnë të njëjtën gjë. Në krahasim me të diplomuarit në 2021 shohim një përmirësim të situatës me 18 pikë përqind në drejtimin Ekonomi-Biznes.
- Si vitet e kaluara, të diplomuarit janë shprehur se arsyeja e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit është pamundësia për të gjetur një vend pune që lidhet me studimet (62%) dhe fakti se puna aktuale ju ofron një page/kushte më të mira (19%).

Figura 9 Lidhja e punës me fushën e arsimit





Figura 10 Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimeve (2020,2021,2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N<sub>1</sub>=44, N<sub>2</sub>=24, N<sub>3</sub>=26, N<sub>4</sub>=51, N<sub>5</sub>=68, N<sub>6</sub>=104.

**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N<sub>1</sub>: EB=15, HT=32, TK=4; N<sub>2</sub>: EB=13, HT=50, TK=5; N<sub>3</sub>: EB=12, HT=80, TK=12..

Tabela 2 Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit

	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Puna që kam më ofron pagë/kushte më të mira	0%	27%	10%	42%	19%
Nuk ka oferta pune në fushën time në rajon	0%	0%	5%	4%	0%
Nuk dua të punoj në një punë që lidhet me studimet e mia	0%	9%	0%	0%	11%
Nuk gjeta një vend pune që lidhet me studimet e mia	100%	64%	85%	38%	62%
Tjetër	0%	0%	0%	15%	8%

Shënim: Rezultatet janë rumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: N<sub>1</sub>=11, N<sub>2</sub>=11, N<sub>3</sub>=20, N<sub>4</sub>=26, N<sub>5</sub>=37.

### 3.3 Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës

#### Si lidhet puna aktuale e të diplomuarve të punësuar me degën dhe njohuritë e fituara gjatë studimeve?

- Në 2022, 31% e të anketuarve tregojnë se i përdorin “jashtëzakonisht shumë” njohuritë e fituara në shkollë, 13% “shumë”, 17% janë shprehur “disi”, ndërkohë që 19% janë shprehur “pak” dhe 19% “aspak”.
- Mesatarisht, ndër vite, 47% e nxënësve kanë vlerësuar me “shumë/jashtëzakonisht shumë” nivelin e përdorimit të njohurive të fituara në shkollë. Përqindja më e lartë shënohet tek të diplomuarit në 2020 me 61%, ndërkohë që në 2022 ajo shënon 44% si një vit më parë.
- Përqindja e të diplomuarve që shprehen me “shumë/jashtëzakonisht shumë” rreth lidhjes të pozicionit aktual të punës me studimet ka pësuar një rritje të lehtë në pesë vitet e fundit, suke shënuar 44% në 2022.

Tabela 3 Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve

	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
Të diplomuar në 2017	26%	15%	17%	26%	17%
Të diplomuar në 2018	0%	29%	17%	38%	17%
Të diplomuar në 2019	11%	39%	4%	21%	25%
Të diplomuar në 2020	4%	31%	4%	55%	6%
Të diplomuar në 2021	25%	13%	18%	16%	28%
Të diplomuar në 2022	19%	19%	17%	13%	31%

Shënim: Rezultatet janë rumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: N<sub>1</sub>=54, N<sub>2</sub>=24, N<sub>3</sub>=28, N<sub>4</sub>=51, N<sub>5</sub>=68, N<sub>6</sub>=104.

Tabela 4 Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet

	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
Të diplomuar në 2017	30%	9%	22%	30%	9%
Të diplomuar në 2018	46%	4%	17%	21%	13%
Të diplomuar në 2019	25%	29%	11%	11%	25%
Të diplomuar në 2020	12%	37%	6%	39%	6%
Të diplomuar në 2021	35%	6%	7%	19%	32%
Të diplomuar në 2022	25%	18%	14%	13%	31%


Shënim: Rezultatet janë rumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: N<sub>1</sub>=54, N<sub>2</sub>=24, N<sub>3</sub>=28, N<sub>4</sub>=51, N<sub>5</sub>=68, N<sub>6</sub>=104.

### 3.4 Niveli i pagave

#### Cili është niveli i pagave për të diplomuarit e punësuar një vit pas diplomimit?


- Parë në një këndvështrim krahasues, niveli i pagave të të diplomuarve ndër vite vjen në rritje, duke arritur nivelin më të lartë tek të gjurmuarit e diplomuar në dy vitet e fundit.
- 37% e të diplomuarve kanë një rrogë më të lartë se 50,000 LEK (prej të cilëve 18% kanë një rrogë neto më të lartë se 80,000 LEK) dhe 37% një rrogë 35,001-50,000.
- Përqindja e të diplomuarve me pagë më të ulët se 35,000 LEK ka rënë ndjeshëm në dy vitet e fundit, duke shkuar nga 87% në 2017 në 27% në 2021. Kjo diferencë është reflektuar në rritjen e numrit të të diplomuarve në fashat me pagë më të lartë. Në 2022, 37% e të gjurmuarve kanë një pagë 35,001-50,000 LEK, 11% pagë 50,001-65,000 LEK dhe 8% pagë 65,001-80,000.
- Është drejtimi Hoteleri-Turizëm dhe Ekonomi-Biznes të cilët paguhet më mirë me 42% dhe 38% të të diplomuarve me pagë më të lartë se 50,000 LEK. 28% e të punësuar të drejtimit Hoteleri-Turizëm kishin një nivel page më të lartë se 80,000 LEK.
- Një diferencë e madhe shihet edhe ndërmjet djemve dhe vajzave; 81% e djemve marrin një pagë neto mbi 35,000 LEK përkundrajt 14% të vajzave.

Figura 9 Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net)




**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: N<sub>1</sub>=44, N<sub>2</sub>=24, N<sub>3</sub>=26, N<sub>4</sub>=51, N<sub>5</sub>=68, N<sub>6</sub>=104.

Figura 12 Niveli i pagave sipas drejtimit (2021) TK



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: N<sub>1</sub>=12, N<sub>2</sub>=80, N<sub>3</sub>=12.

Figura 13 Niveli i pagave sipas gjinisë (2021) F



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: N<sub>1</sub>=72, N<sub>2</sub>=

**Commented [U1]:** Mungojne fashat 50-65 dhe 65-80 tek Tekstil Konfeksion


**Commented [U2]:** Mungon fasha 65-80 tek femrat

### 3.5 Kushtet e punës

#### Cilat janë karakteristikat kryesore dhe kushtet e punës për grupin e diplomuarve të punësuar?


- Përgjithësisht të gjithë të diplomuarit në marrëdhënie pune punojnë me kohë të plotë në 2022 (97%); mesatarja ndër vite është 88%.
- 6 nga 10 të punësuarit pune janë të angazhuar në mikro-ndërmarrje me nga 1-9 punonjës, në krahasim me raportin 7 nga 10 në vitet e kaluara. Përfundimisht bëjnë të diplomuarit në 2019, ku 9 nga 10 prej tyre ishin të punësuar në kompani me të tillë tipologji. Paralelisht, në 2022, vihet re një përmirësim i situatës së të punësuarve që punojnë në biznese të mëdha, ku 27% punojnë në biznese me 10-49 punonjës dhe 14% në biynese me mbi 50 punonjës.
- Situata vazhdon të mbetet jo e mirë për sa i përket mundësisë që kanë të diplomuarit në marrëdhënie pune për të lidhur një kontratë. Gjithsesi në 2022 vihet re një përmirësim i situatës në krahasim me dy vitet pararendës. Nga një mesatare 63% në 2020 dhe 2021, në 2022 vetëm 41% kanë deklaruar se janë pa kontratë ndërkohë që 27% të të diplomuarve kanë nënshkruar një kontratë me afat të pacaktuar dhe 32% me afat të caktuar.
- Për sa i përket ndërgjegjësimit të të gjurmuarve rreth pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, 78% deklarojnë se sigurimet u pagohen nga punëdhënësi, 14% se nuk janë në dijeni dhe 8% deklarojnë se nuk iu paguhen sigurimet. Këto janë vlerat më të mira ndër vite.

Figura 10 Punësimi me kohë të plotë përkundrejtë me kohë të pjesshme




**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: N<sub>1</sub>=38, N<sub>2</sub>=20, N<sub>3</sub>=21, N<sub>4</sub>=42, N<sub>5</sub>=57, N<sub>6</sub>=92.

Figura 11 Madhësia e kompanisë




**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: N<sub>1</sub>=38, N<sub>2</sub>=20, N<sub>3</sub>=21, N<sub>4</sub>=42, N<sub>5</sub>=57, N<sub>6</sub>=92.

Figura 12 Lloji i kontratës



**Shënim:** Rezultatet janë rumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N<sub>1</sub>=38, N<sub>2</sub>=20, N<sub>3</sub>=21, N<sub>4</sub>=42, N<sub>5</sub>=57, N<sub>6</sub>=92.

Figura 13 Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi



**Shënim:** Rezultatet janë rumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N<sub>1</sub>=38, N<sub>2</sub>=20, N<sub>3</sub>=21, N<sub>4</sub>=42, N<sub>5</sub>=57, N<sub>6</sub>=92.

### 3.6 Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqshmërinë me vendin e punës

#### Sa të sigurt dhe të stabilizuar ndjehen të diplomuarit në vendin e tyre të punës?

- Gjysma e të diplomuarve në 2022 ndihen të sigurt ose shumë të sigurt me punën e tyre, duke ruajtur të njëjtin nivel si një vit më parë. Megjithatë vihet re një rritje prej 10 pikë përqindje të numrit të të diplomuarve të cilët ndihen (shumë) të pasigurt (28% tek të diplomuarit në 2021, 38% e të diplomuarve në 2022).
- Perceptimi i sigurisë nga brezi në brez ndryshon, duke e bërë të vështirë identifikimin e një trendi.
- Kënaqësia në vendin e punës është relativisht më e lartë në krahasim me sigurinë tek të diplomuarit e shkollës Hamdi Bushati. Në 2022, 85% janë shprehur (shumë) të kënaqur (27 pikë përqind më shumë se vitin e kaluar, vlera më e lartë ndër vite), ndërkohë që përqindja e atyre që janë shprehur (shumë) të pakënaqur është vetëm 3%.

Tabela 5 Perceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale

	Të diplomuar 2017	Të diplomuar 2018	Të diplomuar 2019	Të diplomuar 2020	Të diplomuar 2021	Të diplomuar 2022
<b>Shumë i/e pasigurt</b>	0	3 (15%)	3 (14%)	0	8 (14%)	<b>19 (21%)</b>
<b>I/e pasigurt</b>	1 (3%)	0	3 (14%)	2 (5%)	8 (14%)	<b>16 (17%)</b>
<b>Neutral</b>	8 (21%)	13 (65%)	7 (33%)	11 (26%)	14 (25%)	<b>9 (10%)</b>
<b>I/e sigurt</b>	28 (74%)	4 (20%)	7 (33%)	28 (67%)	18 (32%)	<b>27 (29%)</b>
<b>Shumë i/e sigurt</b>	1 (3%)	0	1 (5%)	1 (2%)	9 (16%)	<b>21 (23%)</b>
<b>Shumë i/e pakënaqur</b>	0	2 (10%)	2 (10%)	0	7 (12%)	<b>1 (1%)</b>
<b>I/e pakënaqur</b>	1 (3%)	0	3 (14%)	0	5 (9%)	<b>2 (2%)</b>
<b>Neutral</b>	8 (21%)	12 (60%)	3 (14%)	13 (31%)	12 (21%)	<b>11 (12%)</b>
<b>I/e kënaqur</b>	27 (71%)	4 (20%)	12 (57%)	26 (62%)	26 (46%)	<b>42 (46%)</b>
<b>Shumë i/e kënaqur</b>	2 (5%)	2 (10%)	1 (5%)	8 (7%)	7 (12%)	<b>36 (39%)</b>

**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N<sub>1</sub>=38, N<sub>2</sub>=20, N<sub>3</sub>=21, N<sub>4</sub>=42, N<sub>5</sub>=57, N<sub>6</sub>=92.

### 3.7 Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë

#### Sa duhet të presin mesatarisht të diplomuarit derisa të fillojnë punën e tyre të parë?


- Në dy brezat e fundit vihet re një përmirësim i madh në lidhje me periudhën kohore që iu është dashur të diplomuarve për gjetjen e një vendi pune.
- 82% e të diplomuarve në 2022 janë kontraktuar para se të diplomohen, duke ruajtur të njëjtin nivel si një vit më parë. Kjo vlerë është më e larta ndër vite, duke qënë se në brezat e kaluar më pak se gjysma arrinin të gjenin punën e tyre të parë para se të përfundonin studimet.
- 7% është numri i të diplomuarve të cilët arrijnë të punësohen 1 muaj pas diplomimit dhe 3% i atyre që punësohen 1-3 muaj pas diplomimit/3-6 muaj pas diplomimit/6-9 muaj pas diplomimit apo 9-12 muaj pas diplomimit.
- Tek brezat e kaluar mesatarisht 45% gjenin një punë para diplomimit, 14% në muajin e parë pas diplomimit, 9% 1-3 muaj pas diplomimit, 11% 3-6 muaj pas diplomimit dhe 20% 6 muaj pas diplomimit.

Tabela 6 Periudha kohore në kërkim të një pune

	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Para diplomimit	41%	52%	50%	37%	81%	82%
1 muaj pas diplomimit	28%	8%	7%	13%	0%	7%
1 - 3 muaj pas diplomimit	17%	8%	7%	6%	7%	3%
3 - 6 muaj pas diplomimit	6%	12%	14%	12%	5%	3%
6 - 9 muaj pas diplomimit	4%	20%	11%	13%	4%	2%
9 - 12 muaj pas diplomimit	6%	0%	11%	19%	4%	4%

**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N<sub>1</sub>=48, N<sub>2</sub>=21, N<sub>3</sub>=23, N<sub>4</sub>=43, N<sub>5</sub>=63, N<sub>6</sub>=107.

Figura 14 Periudha kohore në kërkim të një pune (të diplomuarit 2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=107.

### 3.8 Mënyrat e gjetjes së punës së parë

#### Si e gjejnë të diplomuarit punën e tyre të parë?

- Nëse krahasojmë të gjithë brezat, forma më e zakonshme nëpërmjet së cilës të diplomuarit kanë gjetur punë për herë të parë është lidhjet personale të pjesëtarëve të familjes dhe të njohurit e tyre.
- Në dy vitet e fundit përqindjet e kësaj mënyre të gjetjes së punës është ulur në nivelin 60%-62%, nga një mesatare prej 81% tek të diplomuarit në 2017-2022.
- Paralelisht, vihet re një rritje të numrit të të diplomuarve të cilët arrijnë të punësohen në sajë të praktikës profesionale në biznes, duke arritur nivelin 25% në 2021 dhe 23% në 2022 ndërkohë që më parë maksimumi shënonte 10%.

#### Si i ndihmon shkolla gjatë periudhës së tranzicionit drejt tregut të punës?

- Në 2022 të anketuarit shprehen se shkolla ndihmon në mënyra të ndryshme për gjetjen e punës së parë. 39% shprehen se kanë mësuar si të kërkojnë dhe të aplikojnë për punë, 49% janë orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit dhe 39% i ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë.
- Krahasuar me një vit më parë është ulur me 14 pikë përqindje niveli i të anketurave që deklarojnë se shkolla nuk i ka dhënë asnjë ndihmë.

Tabela 7 Mënyrat e gjetjes së punës së parë

	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale, gazetë	1 2%	0	0	0	2 3%	1 1%
Nga njohjet, lidhjet familjare, miqtë	40 83%	15 71%	21 91%	33 77%	38 60%	66 62%
Nga praktika profesionale në biznes	5 10%	0	0	4 9%	16 25%	25 23%
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim	0	4 19%	0	3 7%	2 3%	2 2%
Nga mësuesit	0	0	1 4%	0	3 5%	11 10%
Nga Zyra e Punësimit	1 2%	1 5%	0	0	0	0
Nga qendra e karrierës/njësia e zhvillimit në shkollë	1 2%	1 5%	1 4%	2 5%	1 2%	1 1%
Tjetër	0	0	0	1 2%	1 2%	1 1%

**Shënim:** Kjo është pyetje me përgjigje të shumfishta. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza:** N<sub>1</sub>=48, N<sub>2</sub>=21, N<sub>3</sub>=23, N<sub>4</sub>=43, N<sub>5</sub>=63, N<sub>6</sub>=107.

Tabela 8 Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë

	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Kam mësuar si të kërkoj dhe të aplikoj për punë	57%	88%	64%	90%	35%	39%
Më ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit	35%	8%	14%	8%	37%	49%
Më ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë	2%	8%	14%	2%	28%	39%
Përgjithësisht nuk më ka ndihmuar	9%	4%	11%	0%	32%	18%
Tjetër	0%	4%	0%	0%	3%	5%


**Shënim:** Kjo është pyetje me përgjigje të shumëfishta. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza:** N<sub>1</sub>=54, N<sub>2</sub>=24, N<sub>3</sub>=28, N<sub>4</sub>=51, N<sub>5</sub>=68, N<sub>6</sub>=104.

### 3.9 Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme

#### Çfarë kualifikimi të mëtejshëm po ndjekin të diplomuarit?


- Nga brezi në brez numri i të gjurmuarve që vazhdojnë studime të mëtejshme pas diplomimit nga shkolla Hamdi Bushati vjen në rënie, duke shënuar përqindjen më të ulët në 2021, 3%, ndërkohë që në 2022 shënon 8%.
- Në 2022, ndryshe nga vitet e tjera, kemi një përqindje më të lartë të të diplomuarve që studiojnë dhe punojnë në të njëjtën kohë (8%).
- Nga të diplomuarit në 2022 18% kanë zgjedhur të vazhdojnë një kurs profesional pas diplomimit dhe 77% kanë vazhduar studimet pranë një universiteti.
- 59% pohojnë se fusha e studimeve që po ndjekin lidhet me drejtimin e përzgjedhur gjatë shkollës së mesme profesionale dhe 50% janë shprehur se po ndjekin studimet për një kualifikim më të lartë.

Figura 15 Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme



**Shënim:** Rezultatet janë rumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N<sub>1</sub>=91, N<sub>2</sub>=60, N<sub>3</sub>=56, N<sub>4</sub>=88, N<sub>5</sub>=93, N<sub>6</sub>=144.

Figura 16 Llojet e kualifikimeve të mëtejshme



Shënim: Rezultatet janë rumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: N<sub>1</sub>=16, N<sub>2</sub>=10, N<sub>3</sub>=10, N<sub>4</sub>=8, N<sub>5</sub>=4, N<sub>6</sub>=22.

Figura 18 Lloji i universitetit





Figura 17 Lidhja e fushës së studimeve/trajtimeve me profesionin



Shënim: Rezultatet janë rumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: N<sub>1</sub>=8, N<sub>2</sub>=4, N<sub>3</sub>=22.

Tabela 9 Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme

	Të diplomuar 2017	Të diplomuar 2018	Të diplomuar 2019	Të diplomuar 2020	Të diplomuar 2021	Të diplomuar 2022
Për të fituar një kualifikim më të lartë	44%	60%	38%	75%	25%	50%
Për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë	56%	20%	25%	0%	25%	23%
Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale	0%	10%	38%	25%	50%	23%
Nuk po gjeja dot punë	0%	10%	0%	0%	0%	0%

Shënim: Rezultatet janë rumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: N<sub>1</sub>=16, N<sub>2</sub>=10, N<sub>3</sub>=10, N<sub>4</sub>=8, N<sub>5</sub>=4, N<sub>6</sub>=22.

### 3.10 Të diplomuarit pa punë

#### Çfarë vështirësish hasin të diplomuarit që gjenden pa punë një vit pas diplomimit?


- Papunësia shënon vlerën më të ulët tek të diplomuarit në 2022 me 18%, ose në vlera absolute 26 nga 144 të diplomuar. Prej tyre 15 (58%) po kërkojnë për një mundësi punësimi.
- Një vlerësim krahasues ndër vite nxjerr në pah se arsyet më madhore që mendohet të sjellin pamundësinë për të gjetur një punë janë: mospërputhja e ofertës për punë me profilin e studimit (23%) dhe mungesa e kontakteve të duhura për punë (27%). Ndërkohë që të gjurmuarit e brezit të fundit janë shprehur se u mungon eksperiencia e punës në 27% të rasteve dhe njohuritë që kam marrë nga shkolla nuk përputhen me tregun e punës në 13%.

- Të pyetur rreth formave që përdorin për të kërkuar një vend punë 11 (73%) e të diplomuarve në 2022 kanë përzgjedhur 'nëpërmejt njohjeve ose lidhjeve familjare'; një përqindje më e ulët se vitet e tjera. Ndërkohë është rritur niveli i të diplomuarve që shprehen se kanë kontaktuar drejtpërdrejtë me bizneset (4).
- 4 nga 11 (36%) të diplomuarit e papunë të cilët nuk po kërkojnë për një vend pune kujdesen për fëmijët/familjen dhe 3 (27%) nuk kanë dëshirë të punojnë, ndërkohë 2 (18%) kanë në plan të largohen nga vendi.
- 58% e të diplomuarve të papunë në 2022 kanë qenë në marrëdhënie pune më parë. Ky rezultat është i lartë në krahasim me brezat e shkuar.

Tabela 10 Papunësia ndër vite

Të diplomuar në 2017	32%
Të diplomuar në 2018	30%
Të diplomuar në 2019	31%
Të diplomuar në 2020	31%
Të diplomuar në 2021	23%
Të diplomuar në 2022	18%

Figura 19 Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë



**Shënim, tabela 10:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: N<sub>1</sub>=91, N<sub>2</sub>=60, N<sub>3</sub>=56, N<sub>4</sub>=88, N<sub>5</sub>=93, N<sub>6</sub>=144.


**Shënim, figura 23:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: N<sub>1</sub>=27, N<sub>2</sub>=21, N<sub>3</sub>=26.

Tabela 11 Arsytet kryesore pas punësisë

	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Më mungon eksperiencia e punës	3%	0%	0%	0%	10%	27%
Njohuritë që kam marrë nga shkolla nuk përputhen me tregun e punës	3%	0%	0%	0%	0%	13%
Ofertat për punë nuk lidhen me arsimimin tim	14%	39%	6%	67%	10%	7%
Nuk kam njohjet/kontaktet e duhura për të gjetur një punë	31%	22%	44%	27%	20%	7%
Nuk ka punë në qarkun tim	7%	17%	11%	7%	0%	7%
Jam i/e angazhuar në punë familjare	38%	22%	22%	0%	0%	0%
Nga situata e krijuar nga pandemia e COVID-	0%	0%	17%	0%	0%	0%
Nuk di si të kërkoj për punë	0%	0%	0%	0%	10%	7%
Tjetër	3%	0%	0%	0%	50%	33%

**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: N<sub>1</sub>=29, N<sub>2</sub>=18, N<sub>3</sub>=18, N<sub>4</sub>=15, N<sub>5</sub>=10, N<sub>6</sub>=15.

Figura 20 Metodat e kërkimit për punë (të diplomuar në 2020, 2021, 2022)




**Shënim:** Kjo është pyetje me përgjigje të shumëfishta. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza:** N<sub>1</sub>=15, N<sub>2</sub>=10, N<sub>3</sub>=15.

Tabela 12 Arsyet kryesore e mos kërkimit për punë

	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
<b>Nuk kam dëshirë të punoj për momentin</b>	0	0	3 27%
<b>Kam në plan të largohem nga vendi</b>	10 84%	4 36%	2 18%
<b>Kujdesem për fëmijët/familjen</b>	1 8%	6 55%	4 36%
<b>Tjetër</b>	1 8%	1 9%	2 18%

**Shënim, tabela 12:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N<sub>1</sub>=12, N<sub>2</sub>=11, N<sub>3</sub>=11.

Figura 21 Niveli i të diplomuarve papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune



**Shënim, figura 25:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N<sub>1</sub>=29, N<sub>2</sub>=18, N<sub>3</sub>=18, N<sub>4</sub>=27, N<sub>5</sub>=21, N<sub>6</sub>=26.

### 3.11 Propozimet për përmirësim në shkollë

#### Për t'i përgatitur më mirë nxënësit për tregun e punës, në çfarë aspektesh ka nevojë për përmirësim shkolla?


- Në një vlerësim retrospektiv të gjurmuarit e këtij viti mendojnë se aspektet që lidhen me praktikën në biznes janë ato që kanë më shumë nevojë për përmirësim nga shkolla. Gjithsesi shkalla e nevojës për 'shumë ose jashtëzakonisht shumë' përmirësim në këto aspekte është më e ulët krahasuar me vitet e kaluara.
- Sipas rezultateve, të diplomuarit në 2022 mendojnë se bashkëpunimi me zyrat e punës (39%), bashkëpunimi me bizneset (33%) dhe këshillimi në karrierë (33%) janë ato aspekte ku nevoja për përmirësim është më e lartë. Një trend i ngjashëm vihet re edhe tek të gjurmuarit e viteve të shkuara.
- Nga ana tjetër, elementë si kurrikula dhe infrastruktura në shkollë vlerësohen nga të gjurmuarit si elementë ku nevoja për përmirësim është e vogël (19% dhe 21%).
- Të pyetur nëse do të zgjidhnin të njëjtën shkollë/degë, vlen për t'u shënuar se tek të diplomuarit në 2021 dhe 2022 kemi një rënie në krahasim me vitet e kaluara, sidomos në përqindjen e nxënësve që do të ngjdhnin të njëjtën shkollë në drejtimet Ekonomi-Biznes (77%) dhe Tekstil-Konfeksione (50%).
- Nëse i studiojmë të dhënat të disagreguara sipas gjinisë vihet re një ndryshim me 10 pikë përqindje tek femrat krahaduar me meshkujt, ku vetëm 74% e tyre kanë pohuar se do të zgjidhnin të njëjtën shkollë.

Tabela 13 Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkollë "shumë/jashtëzakonisht shumë"

	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Infrastruktura	20%	17%	18%	0%	37%	21%
Kurrikula		21%	11%	0%	35%	19%
Tekstet dhe materialet	7%	21%	18%	0%	39%	23%
Metodat e mësimdhënies	9%	17%	18%	0%	39%	24%
Aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve		17%	14%	0%	38%	26%
Praktika në shkollë	17%	21%	14%	36%	39%	27%
Praktika në biznes	15%	17%	32%	41%	44%	27%
Këshillimi i karrierës	11%	17%	4%	11%	38%	33%
Bashkëpunimi me bizneset		21%	32%	92%	46%	33%
Bashkëpunimi me zyrat e punësimit	39%	96%	68%	100%	52%	39%

**Shënim:** Kjo është pyetje ku janë marrë të dhënat e të diplomuarve që janë përgjigjur "shumë/jashtëzakonisht shumë". Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza:** N<sub>1</sub>=54, N<sub>2</sub>=24, N<sub>3</sub>=28, N<sub>4</sub>=88, N<sub>5</sub>=49, N<sub>6</sub>=144.

Figura 22 Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N<sub>1</sub>=60, N<sub>2</sub>=56, N<sub>3</sub>=88, N<sub>4</sub>=93, N<sub>6</sub>=144.

Tabela 14 Përzgjedhja e së njëjtës degë/shkollë sipas drejtimit

		Ekonomi-biznes	Hoteleri-Turizëm	Tekstil-Konfeksione
Të diplomuar në 2018	Degë	100%	97%	100%
	Shkollë	100%	97%	82%
Të diplomuar në 2019	Degë	94%	92%	79%
	Shkollë	100%	100%	100%
Të diplomuar në 2020	Degë	100%	96%	100%
	Shkollë	100%	100%	91%
Të diplomuar në 2021	Degë	78%	87%	83%
	Shkollë	44%	81%	50%
Të diplomuar në 2022	Degë	94%	92%	83%
	Shkollë	77%	86%	50%

**Shënim:** Rezultatet janë rrrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N<sub>1</sub>: EB=16, HT=33, TK=11; N<sub>2</sub>: EB=16, HT=26, TK=14; N<sub>3</sub>: EB=31, HT=46, TK=11; N<sub>4</sub>: EB=18, HT=63, TK=12; N<sub>5</sub>: EB=17, HT=109, TK=18.

Figura 24 Përzgjedhja e së njëjtës degë sipas gjinisë





Figura 23 Përzgjedhja e së njëjtës shkollë sipas gjinisë



**Shënim:** Rezultatet janë rrrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N<sub>1</sub>: M=43, F=17; N<sub>2</sub>: M=39, F=17; N<sub>3</sub>: M=70, F=18; N<sub>4</sub>: M=65, F=28; N<sub>5</sub>: M=90, F=54.

### 3.12 Planet për të ardhmen

#### Çfarë planesh kanë të diplomuarit për të ardhmen e tyre të afërt në aspektin profesional dhe të kualifikimit të mëtejshëm?

- Ndryshe nga vitet e kaluara, në dy vitet e fundit të diplomuarit kanë primare sipërmarrjen pasi në 34% dhe 32% të rasteve ata janë shprehur se në planet e tyre të afërta është hapja e një biznesi.
- Në 2022 një përqindje e lartë vihet re edhe tek të diplomuarit që duan të emigrojnë jashtë vendit (33%). Kemi një rritje me 7 pikë përqindje nga viti i kaluar dhe 17 pikë përqindje nga 2020.
- 24% e të gjurmuarve në 2022 dëshirojnë të jenë punësuar në dy vitet e ardhshme.

Tabela 15 Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme

	Të diplomuar në 2017	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
<b>Të jem punësuar</b>	11%	37%	41%	31%	31%	24%
<b>Të kem gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit</b>	43%	30%	23%	28%	12%	15%
<b>Të kem filluar biznesin tim</b>	23%	7%	4%	10%	34%	32%
<b>Të kem ndjekur studime të mëtejshme</b>	15%	17%	16%	10%	6%	9%
<b>Të kem emigruar jashtë vendit</b>	19%	20%	13%	16%	26%	33%
<b>Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit</b>	0%	0%	2%	0%	2%	0%
<b>Tjetër</b>	0%	0%	5%	6%	9%	8%

Shënim: Kjo është pyetje me përgjigje të shumëfishta. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. Baza: N<sub>1</sub>=91, N<sub>2</sub>=60, N<sub>3</sub>=56, N<sub>4</sub>=88, N<sub>5</sub>=93, N<sub>6</sub>=144.

#### 4. Përfundime

Në këtë raport paraqiten rezultatet kryesore nga gjurmimi i të diplomuarve të shkollës 'Hamdi Bushati' duke filluar me brezin e nxënësve të diplomuar në 2017.

Disa nga gjetjet kryesore të gjurmimit **për të diplomuarit e 2022** janë përmbledhur më poshtë:

- Për të dytin vit rradhazi, 100% e të diplomuarve u gjurmuan një vit pas diplomimit.
- Nga një total prej 144 të anketuarish, 72% prej tyre janë në marrëdhënie pune, 18% pa punë dhe 8% po ndjekin kualifikime të mëtejshme, duke shënuar kështu nivelet më të mira ndër vite.
- 73% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, 71% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 67% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksion janë të punësuar një vit pas diplomimit. Krahasuar me një vit më parë përmirësimin më të madh e shohim në drejtimin Tekstil-Konfeksion me 25 pikë përqindje.
- 58% e të diplomuarve në 2022 deklarojnë se puna që ata bëjnë lidhet me studimet e tyre (68% Hoteleri-Turizëm, 33% Ekonomi-Biznes dhe 17% në Tekstil-Konfeksion). Në 62% të rasteve kjo mospërputhje vjen sepse të diplomuarit nuk kanë arritur të gjejnë një vend pune që lidhet me studimet e ndjekura.
- Niveli i pagave të të diplomuarve ndër vite vjen në rritje. 37% e të diplomuarve kanë një rrogë më të lartë se 50,000 LEK (prej të cilëve 18% kanë një rrogë neto më të lartë se 80,000 LEK) dhe 37% një rrogë 35,001-50,000. **Është drejtimi Hoteleri-Turizëm i cili paguhet më mirë me 78% të të diplomuarve me pagë më të lartë se 35,000 LEK, ndërkohë që 46% në Ekonomi-Biznes dhe 20% në Tekstil Konfeksion kanë këtë nivel page.**
- 82% e të diplomuarve në 2022 janë kontraktuar para se të diplomohen, duke ruajtur të njëjtin nivel si një vit më parë. Kjo vlerë është më e larta ndër vite, duke qënë se në brezat e kaluar më pak se gjysma arrinin të gjenin punën e tyre të parë para se të përfundonin studimet.
- Për të gjithë brezat lidhjet personale dhe të njohurit ishin forma më e zakonshme nëpërmjet së cilës të diplomuarit gjenin punën e tyre të parë. Ashtu si në 2021, edhe këtë vit renditet e dyta gjetja e një vendi pune në sajë të praktikës profesionale në biznes, në nivelin 21% në 2022.
- Vetëm 8% e të gjurmuarve ndjekin kualifikime të mëtejshme dhe 8% studiojnë dhe punojnë në të njëjtën kohë.
- Në një vlerësim retrospektiv, të diplomuarit e 2022 mendojnë se aspektet që kanë nevojë për 'shumë ose jashtëzakonisht shumë' përmirësim në shkollë janë: bashkëpunimi me zyrat e punës (39%) dhe bashkëpunimi me bizneset (33%) dhe këshillimi i karrierës (33%). Ndërkohë, kurrikula dhe infrastruktura janë aspkete që vlerësohet se nuk ka nevojë për 'shumë ose jashtëzakonisht shumë' përmirësim.
- Të pyetur nëse do të zgjidhnin të njëjtën shkollë/degë, vlen për t'u shënuar se tek të diplomuarit në 2021 dhe 2022 kemi një rënie në krahasim me vitet e kaluara dhe sidomos në përqindjen e nxënësve që do të ngjidhnin të njëjtën shkollë në drejtimet Ekonomi-Biznes (77% në 2022) dhe Tekstil-Konfeksione (50% në 2022).